



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. 21303 Prot

Shkodër, më 27.8.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë, për shqyrtim, projekt-vendimin dhe relacionin: "Për miratimin e zbatimit të projektit *SOILSTICE – Forcimi i institucioneve dhe lokaliteteve tona për transformimin e tokës*, financuar në kuadër të programit HORIZON-MISS-2025-05, si dhe për miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, për realizimin e këtij projekti."

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____._____.2026

“PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT SOILSTICE - FORCIMI I INSTITUCIONEVE DHE LOKALITETEVE TONA PËR TRANSFORMIMIN E TOKËS, FINANCUAR NË KUADËR TË PROGRAMIT HORIZON-MISS-2025-05” SI DHE MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT TË BUXHETIT TË BASHKISË SHKODËR, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 84, DATË 18.12.2025, PËR REALIZIMIN E KËTIJ PROJEKTI.”

Këshilli i Bashkisë Shkodër sot me datë _____._____.2026, në mbështetje të nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Udhëzimi nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Ligji nr. 87/2025, datë 12.12.2025 ‘Për buxhetin e vitit 2026, i ndryshuar; Udhëzimi Plotësues i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”; ligjit nr. 47/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizont Evropa – Programi kuadër për Kerkimin dhe Inovacionin”; si dhe Marrëveshjes së Grantit nr. 101297028 “SOILSTICE”, administruar në Bashkinë Shkodër me nr. prot. 1764/b, datë 26.05.2026, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____ prot., datë _____ të administratës së Bashkisë Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. “Për miratimin e zbatimit të projektit SOILSTICE – Forcimi i institucioneve dhe lokaliteteve tona për transformimin e tokës, financiar në kuadër të programit HORIZON-MISS-2025-05, si dhe për miratimin e shitesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër,

të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 18.12.2025, për realizimin e këtij projekti.”

2. Vlera totale e financimit për Bashkinë Shkodër do të jetë **60,000.00 euro**, e konvertuar në lekë në shumën 5,728,200 Lekë, sipas kursit zyrtar 95.47 ALL marrë nga *Banka e Shqipërisë* me datë 25 maj 2026, kur është nënshkruar marrëveshja e grantit. Projekti financohet tërësisht nga donatori, ndërsa Bashkia mbulon detyrimin për TVSH-në që lidhet me zbatimin e tij”. Projekti shtrin efektet financiare për 36 muaj, duke filluar nga 1 shtator 2026.
3. Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta vlerën e **TVSH-së** e cila nuk njihet si shpenzim nga donatori. Për vitin 2026, mbulimi i vlerës së TVSH-së me vlerën 20,000 lekë do të realizohet nga tepricat e fondit të programit **AC141: “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural”**, Fisha: **P.AC141.Q5.O1.A1** Trajtimi i qenve te rrugës, A.1 Trajtimi i qenve te rruges. Ndërsa për periudhën e kohëzgjatjes së projektit 2026–2029, fondet për mbulimin e TVSH-së për vitin 2026 do të planifikohen nga rialokimi i fondeve të drejtorisë së bujqësisë, për vitet 2027-2029 do të planifikohen nëpërmjet kërkesave buxhetore për PBA 2027–2029.

Pakësime viti 2025:

në lekë

Nr.	Nr. Programi	Programi	Produkti	Aktiviteti/ Emërtimi	Art.602 Shpenzime operative	Institucioni Likuidues
1.	AC141 Kap.5	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural	V422AAB Trajtimi i kafshëve endacake	P.AC141.Q5.O1.A1. Trajtimi i qenve te rrugës A.1 Trajtimi i qenve te rrugës	20,000	Bashkia Shkodër
Totali					20,000	

4. Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin AC141: “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural”, PAC141.Q6.O1.A7 Projekti SOILSTICE dhe institucioni likuidues sipas fises: Bashkia Shkodër. sipas detajimit:

Buxheti total nga DONATORI

lekë

Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:			
	(Lek)	Paga (600)	Sigurime shoq + shënd (601)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	256,690	134,268	22,422	100,000	
Shuma 2027	2,201,120	1,165,840	237,360	375,920	422,000
Shuma 2028	1,784,120	1,165,840	237,360	380,920	
Shuma 2029	1,486,270	854,304	184,166	447800	
Shuma totale e Projektit nga Donatori	5,728,200	3,320,252	681,308	1,304,640	422,000

Mbulimi i TVSH me burim financimi fondet e veta në lekë (Shpenzime për TVSH për shpenzime operative dhe shpenzimeve kapitale)

lekë

Shpenzimet e llogaritura			
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	20,000	20,000	
Shuma 2027	129,584	45,184	84,400
Shuma 2028	76,184	76,184	
Shuma 2029	59,560	59,560	
Shuma totale e Bashkëfinancimit me fondet e Bashkise	285,328	200,928	84,400

5. Kërkojmë miratimin e numrit të punonjësve dhe fondeve me vlerë 4,001,560 lekë për 3 (tre) punonjës të planifikuar, me fondet e projektit për vitin 2026–2029, për pozicionet: Koordinator Lokal i Projektit, Specialist i Planifikimit Territorial dhe Specialist i Komunikimit. Fondi i përlllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimet mbulohen nga donatori. Punonjës do të punojnë me kohë të pjesshme, për një periudhë prej 36 (tridhjetë e gjashtë) muajsh, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Emertimi	Punonjës	Arsim i lartë		Arsim i mesëm
		Grupi i diplomimit	Kategori	Klasa
Përgjegjës (Koordinator lokal të projektit - 50% të orëve)	1		III-2	
Specialist (specialist planifikimi territorial - 30% të orëve)	1		IV-2	
Specialist (specialist komunikimi - 20% të orëve)	1		IV-2	

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

*Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse*

Zv. Kryetar

Alban Preka

*Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar*

Ervin Beahimi

Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor

Enke Hoxha

*Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qendrueshëm Ekonomik*

Behar Nemo

*Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit*

Stela Hordesh

*Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Trajtimin të AMTP*

Skënder Haxhi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM EKONOMIK

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____.____.2026

RELACION

“PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT SOILSTICE - FORCIMI I INSTITUCIONEVE DHE LOKALITETEVE TONA PËR TRANSFORMIMIN E TOKËS, FINANCUARNË KUADËR TË PROGRAMIT HORIZON-MISS-2025-05” SI DHE MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT TË BUXHETIT TË BASHKISË SHKODËR, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 84, DATË 18.12.2025, PËR REALIZIMIN E KËTIJ PROJEKTI.”

Të nderuar këshilltarë,

Projekti SOILSTICE – “Forcimi i institucioneve dhe lokaliteteve tona për transformimin e tokës” është një iniciativë evropiane e financuar në kuadër të programit Horizon Europe – HORIZON-MISS-2025-05-SOIL-09, që synon përmirësimin e qeverisjes së tokës, rritjen e ndërgjegjësimit mbi shëndetin e saj dhe forcimin e rolit të autoriteteve lokale, komuniteteve dhe aktorëve të tjerë në mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të tokës.

Tokat e shëndetshme janë një element themelor për përballimin e ndryshimeve klimatike, ruajtjen e biodiversitetit, sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e komuniteteve. Megjithatë, menaxhimi i tokës në Evropë dhe në nivel lokal përballlet me sfida të lidhura me mungesën e koordinimit institucional, kapaciteteve teknike dhe përfshirjes së komunitetit. Projekti SOILSTICE synon të adresojë këto sfida përmes krijimit dhe zbatimit të Marrëveshjeve të Menaxhimit Territorial (Territorial Management Agreements – TMA), si mekanizma bashkëpunimi ndërmjet bashkive, menaxherëve të tokës, fermerëve, qytetarëve dhe institucioneve të tjera.

Në kuadër të projektit, gjatë një periudhe 36-mujore, do të zhvillohen dhe zbatohen 40 Marrëveshje të Menaxhimit Territorial në 11 vende evropiane, ku secila marrëveshje do të përfshijë tregues të matshëm për shëndetin e tokës dhe do të publikohet në platformën digjitale me akses të hapur TMA Studio.

Bashkia Shkodër, si pjesë e këtij projekti, do të përfshihet në aktivitetet për:

- forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës;
- zhvillimin e qasjeve pjesëmarrëse me komunitetin lokal, fermerët dhe aktorët e interesuar;
- përfshirjen e treguesve të shëndetit të tokës në proceset vendimmarrëse dhe planifikimin territorial;

- shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira me autoritete të tjera evropiane;
- mbështetjen e politikave lokale që kontribuojnë në objektivat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen dhe restaurimin e tokës deri në vitin 2030.

Në kuadër të zbatimit të projektit, parashikohet të realizohen këto rezultate konkrete:

- Pjesëmarrja në 4 workshopeve ndërkombëtare;
- Organizimi i 3 workshopeve lokale;
- Përfshirja e rreth 150 pjesëmarrësve në aktivitetet e projektit (8 në workshopet ndërkombëtare dhe 120 në workshopet lokale);
- Organizimi i një Youth Soil Innovation Camp me pjesëmarrjen e 30 të rinjve;
- Sigurimi i pajisjeve për monitorimin e tokës, *(1 laptop, 2 sensorë për monitorimin e tokës, 2 tableta me GPS dhe 1 set pajisjesh demonstrimi për marrjen e mostrave;)*
- Marrja dhe analiza laboratorike e 15 mostrave të tokës për vlerësimin e parametrave fiziko-kimikë dhe biodiversitetit;
- Përgatitja e 2 raporteve të ekspertizës, përkatësisht një raporti teknik/agronomik dhe një ekspertizë juridike për Marrëveshjet Territoriale të Menaxhimit (TMA);
- Hartimi i 2 materialeve të storytelling për promovimin e zonave pilote dhe prodhimi/shpërndarja e 351 materialeve promovuese
- Zbatimi i këtyre aktivite, etj.

Qëllimi kryesor i projektit SOILSTICE është të përmirësojë shëndetin e tokës në Evropë përmes forcimit të qeverisjes pjesëmarrëse dhe krijimit të modeleve të qëndrueshme të menaxhimit territorial. Projekti i përgjigjet sfidave aktuale të fragmentimit të qeverisjes dhe mungesës së njohurive lokale mbi tokën, duke vendosur në qendër bashkëpunimin ndërmjet bashkive, përdoruesve të tokës dhe qytetarëve.

Objektivat kryesore të projektit SOILSTICE janë:

- krijimi dhe zbatimi i modeleve të reja të qeverisjes së tokës përmes Marrëveshjeve të Menaxhimit Territorial;
- rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi rëndësinë e tokës;
- trajnimi i stafit të administratave lokale dhe përfaqësuesve institucionalë;
- zhvillimi i sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të shëndetit të tokës;

Në projektin SOILSTICE marrin pjesë 36 organizata partnere nga 11 vende evropiane. Projekti koordinohet nga ECOLISE dhe përfshin universitete, organizata kërkimore, organizata të shoqërisë civile dhe autoritete vendore nga vende të ndryshme të Evropës. Referuar kushteve dhe udhëzimeve të Programit (REA) (European Research Executive Agency – Agjencia Ekzekutive Evropiane për kërkimin shkencor). Bashkia Shkodër angazhohet të zbatojë projektin në përputhje me manualet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Programi lidhur me këtë kontratë, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Partnerët përfitues:

Rrjeti Evropian për Nismat Komunitare për Ndryshimet Klimatike dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm (ECOLISE), në cilësinë e koordinatorit të projektit, Planeti REVOLVE (REVOLVE PLANET), Arsimi Gaia (GAIA EDUCATION), Sekretariati Evropian i ICLEI,

Rrjeti Evropian i Ekofshatrave (GEN Europe), Shoqata Evropiane LEADER për Zhvillimin Rural (ELARD), Universiteti i Aveiros, Universiteti Wageningen, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), Instituti CO-PLAN për Zhvillimin e Habitatit, Kooperativa Oasis, Agjencia Rajonale e Zhvillimit për Podravje-Maribor, Bashkia Wageningen, Komuna Saint-Gilles, Provinca e Liège, Këshilli i Westmorland dhe Furness, Komuna Saurat, Komuniteti Ndërkomunal i Rajonit të Coimbrës, Brukseli Mjedis (Bruxelles Environnement), Bashkia Amsterdam, Bashkia Vizela, Bashkia Lushnjë, Bashkia Shkodër, Bashkia Berat, Bashkia Elbasan, Bashkia Almóçita, Bashkia Valpaços, Bashkia e Firences, Bashkia San Lazzaro di Savena, Komuna Rueil-Malmaison, Qyteti i Brukselit, Bashkia Burgos, Provinca e Antverpit, Komuna d'Eourres dhe Komuna Kembs.

- Kohëzgjatja e projektit do të jetë 36 muaj nga data e nënshkrimit nga të gjithë partnerët dhe shtrin efektet e tij financiare nga 1 shtatori 2026. Vlera e buxhetit për Bashkinë Shkodër do të jetë 60,000 euro, e konvertuar në lekë në shumën 5,728,200 Lekë, sipas kursit zyrtar 95.47 ALL marrë nga *Banka e Shqipërisë* për datën 25 maj 2026 (që përkon me datën kur është nënshkruar Marrëveshja e grantit). Projekti financohet tërësisht nga donator, ndërsa Bashkia mbulon detyrimin për TVSH-në që lidhet me zbatimin e tij.

Vlera do të transferohet për llogari të Bashkisë Shkodër sipas Udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”.

Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta vlerën e TVSH-së e cila nuk njihet si shpenzim nga donatori. Për vitin 2026, mbulimi i vlerës së TVSH-së me vlerën 20,000 lekë do të realizohet nga tepricat e fondit të programit AC141: “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural”, Fisha: P.AC141.Q5.O1.A1 Trajtimi i qenve të rrugës, A.1 Trajtimi i qenve të rrugës. Ndërsa për periudhën e kohëzgjatjes së projektit 2026–2029, fondet për mbulimin e TVSH-së për vitin 2026 do të planifikohen nga rialokimi i fondeve të Drejtorisë së Bujqësisë, për vitet 2027-2029 do të planifikohen nëpërmjet kërkesave buxhetore për PBA 2027–2029.

Pakësime viti 2025:

në lekë

Nr.	Nr. Programi	Programi	Produkti	Aktiviteti/ Emërtimi	Art.602 Shpenzime operative	Institucion i Likuidues
1.	AC141 Kap.5	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural	V422AAB Trajtimi i kafsheve endacake	P.AC141.Q5.O1.A1. Trajtimi i qenve te rrugës A.1 Trajtimi i qenve te rrugës	20,000	Bashkia Shkodër
Totali					20,000	

Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin AC141: “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural.” sipas detajimit:

Buxheti total në lekë nga DONATORI

lekë

Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:			
	(Lek)	Paga (600)	Sigurime shoq + shënd (601)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	256,690	134,268	22,422	100,000	
Shuma 2027	2,201,120	1,165,840	237,360	375,920	422,000
Shuma 2028	1,784,120	1,165,840	237,360	380,920	
Shuma 2029	1,486,270	854,304	184,166	447,800	
Shuma totale e Projektit nga Donatori	5,728,200	3,320,252	681,308	1,304,640	422,000

Mbulimi i TVSH me burim financimi fondet e veta në lekë (Shpenzime për TVSH, shpenzime operative si dhe shpenzime kapitale)

lekë

Shpenzimet e llogaritura			
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	20,000	20,000	
Shuma 2027	129,584	45,184	84,400
Shuma 2028	76,184	76,184	
Shuma 2029	59,560	59,560	
Shuma totale e Bashkëfinancimit me fondet e veta	285,328	200,928	84,400

Kërkojmë miratimin e numrit të punonjësve dhe fondeve me vlerë 4,001,560 lekë për 3 (tre) punonjës të planifikuar, me fondet e projektit për vitin 2026–2029, për pozicionet: Koordinator Lokal i Projektit, Specialist i Planifikimit Territorial dhe Specialist i Komunikimit. Fondi i përlllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimet mbulohen nga donatori. Punonjës do të punojnë me kohë të pjesshme, për një periudhë prej 36 (tridhjetë e gjashtë) muajsh, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Emërtimi	Punonjës	Arsim i lartë	Arsim i mesëm
-----------------	-----------------	----------------------	----------------------

Emërtimi	Punonjës	Arsim i lartë		Arsim i mesëm
		Grupi i diplomimit	Kategori	Klasa
Përgjegjës (Koordinator lokal të projektit - 50% të orëve)	1		III-2	
Specialist (planifikimi territorial - 30% të orëve)	1		IV-2	
Specialist (komunikimi - 20% të orëve)	1		IV-2	

Vlerësojmë të rëndësishme të nënvizojmë se, Bashkia Shkodër do të mbulojë fillimisht me fondet e veta vlerën e TVSH-së. Njëkohësisht, Bashkia Shkodër do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për paraqitjen e kërkesës për rimbursimin e kësaj vlere pranë SASPAC – Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në përputhje me procedurat dhe kërkesat përkatëse.

Sa më sipër, kërkohet miratimi i shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, në programin P.AC141: Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural .

K R Y E T A R

Benet BECI

Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrushëm Ekonomik

Edurne Memo

Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Mardushaj

Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP

Skela Mardushaj



Nr. 4	P.AC141.Q6.O1.A7 Projekti Soilstice	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit “SOILSTICE” një iniciativë e rëndësishme që zhvillohet në kuadër të Thirrjes Horizon MISS – 2025 - 05 , në bashkëpunim me Agjencinë Ekzekutive Evropiane për kërkimin Shkencor – (REA), e cila mban rolin e partnerit lider. Ky projekt ndërkombëtar synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe angazhimin e qytetarëve, institucioneve dhe aktorëve lokalë për mbrojtjen, restaurimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tokës. Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, aktiviteteve edukative dhe nismave inovative, projekti promovon praktika të qëndrueshme që kontribuojnë në ruajtjen e biodiversitetit, përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe forcimin e qëndrueshmërisë ndaj sfidave klimatike. Qëllimi kryesor i projektit SOILSTICE është të përmirësojë shëndetin e tokës në Evropë përmes forcimit të qeverisjes pjesëmarrëse dhe krijimit të modeleve të qëndrueshme të menaxhimit territorial. Projekti i përgjigjet sfidave aktuale të fragmentimit të qeverisjes dhe mungesës së njohurive lokale mbi tokën, duke vendosur në qendër bashkëpunimin ndërmjet bashkive, menaxherëve të tokës dhe qytetarëve. SOILSTICE synon të zhvillojë dhe zbatojë Marrëveshjet e Menaxhimit Territorial (TMA) si instrumente kryesore për kujdestarinë e tokës në nivel evropian. Këto marrëveshje janë komiza të bashkë-krijuara që integrojnë tregues të matshëm të shëndetit të tokës dhe garantojnë vazhdimësi përtej cikleve politike. Gjatë 36 muajve të zbatimit, projekti synon të krijojë dhe implementojë 40 TMA në 11 vende evropiane, ku secila marrëveshje do të përfshijë të paktën tre indikatorë të shëndetit të tokës dhe do të publikohet në platformën e hapur “TMA Studio”. Kohëzgjatja e projektit është 36 muaj, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës nga të gjithë partnerët. Vlera e buxhetit për Bashkinë Shkodër do të jetë 60,000 euro, e konvertuar në lekë në shumën 5,728,200 Lekë, sipas kursit zyrtar 95.47 ALL marrë nga Banka e Shqipërisë për muajin 25 maj 2026 (që përkon me datën kur është nënshkruar Marrëveshja e grantit). Kontributi i BE-së mbulon 100% të kostove dhe nuk nevojitet bashkëfinancim.		
ii. Synimi i projektit		
Qëllimi kryesor i projektit SOILSTICE është të përmirësojë shëndetin e tokës në Evropë përmes forcimit të qeverisjes pjesëmarrëse dhe krijimit të modeleve të qëndrueshme të menaxhimit territorial. Projekti i përgjigjet sfidave aktuale të fragmentimit të qeverisjes dhe mungesës së njohurive lokale mbi tokën, duke vendosur në qendër bashkëpunimin ndërmjet bashkive, menaxherëve të tokës dhe qytetarëve.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
1. Krijimi dhe funksionalizimi i grupeve lokale të punës – Angazhimi i institucioneve, ekspertëve, organizatave dhe komunitetit për të mbështetur zbatimin e projektit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tokës. 2. Aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuere – Realizimi i fushatave, trajnimeve dhe materialeve informuese për rritjen e ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen e tokës dhe mjedisit. 3. Monitorimi dhe vlerësimi i shëndetit të tokës – Mbledhja dhe analizimi i të dhënave për të vlerësuar gjendjen dhe përmirësimin e cilësisë së tokës. 4. Trajnimi i stafit dhe aktorëve lokalë – Forcimi i kapaciteteve të stafit bashkiak dhe aktorëve lokalë përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të praktikave më të mira.		
b) Rezultatet që prisni		
– Rritja e ndërgjegjësimin të qytetarëve dhe aktorëve lokalë mbi rëndësinë e mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të tokës. – Përmirësimi i kapaciteteve të stafit bashkiak dhe aktorëve lokalë në fushën e qeverisjes pjesëmarrëse dhe menaxhimit të tokës. – Përfshirja aktive e qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe në iniciativat për mbrojtjen e mjedisit. – Përmirësimi i treguesve të shëndetit të tokës dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme të përdorimit të saj. – Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe partnerëve evropianë për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira.		

c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)				
Bashkia Shkodër, Universiteti, Biznese, Komuniteti Organizatata mjedisore, nxënësit dhe studentët.							
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii))							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (në lekë)	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Koordinator lokal të projektit. (50% të orëve) (donatori)	156,690	134,268	22,422			
A.2	Udhëtime (donatori)	100,000			100,000		
A.3	Përmbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (TVSH-fondet e bashkisë.	20,000			20,000		
	Shuma 2026	276,690	134,268	22,422	120,000		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (në lekë)	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Koordinator lokal të projektit. (50% të orëve) (donatori)	783,450	671,340	112,110			
A.2	Specialist të planifikimit territorial. (30% të orëve) (donatori)	410,800	344,000	66,800			
A.3	Specialist i komunikimit. (20% të orëve) (donatori)	208,950	150,500	58,450			
A.4	Udhëtime (donatori)	100,000			100,000		
A.5	Organizimi i 1 workshope lokale (donatori)	82,500			82,500		
A.6	Blerje paisje TIK (laptop + sensor +tablet me gps + paisje demonstrimi) (donatori)	422,000					422,000
A.7	Mostra dhe Analiza laboratorike (donatori)	43,420			43,420		
A.8	Ekspertizë për mjedisit/agronom (donatori)	100,000			100,000		
A.9	Ekspertizë juridik për Marrëveshjet Territoriale të Menaxhimit (TMA) (donatori)	50,000			50,000		
A.10	Përmbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (TVSH-fondet e bashkisë	129,584			45,184		84,400
	Shuma 2027	2,330,704	1,165,840	237,360	421,104	0	506,400
Shpenzimet për çdo aktivitet 2028		Totali në lekë	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Koordinator lokal të projektit. (50% të orëve) (donatori)	783,450	671,340	112,110			
A.2	Specialist të planifikimit territorial. (30% të orëve) (donatori)	410,800	344,000	66,800			

A.3	Specialist i komunikimit. (20% të orëve) (donatori)	208,950	150,500	58,450			
A.4	Udhëtime (donatori)	100,000			100,000		
A.5	Organizimi i 1 workshopi lokal (donatori)	82,500			82,500		
A.6	Organizimi i një workshopi ndërkombëtar (donatori)	155,000			155,000		
A.7	Mostra dhe Analiza laboratorike (donatori)	43,420			43,420		
A.8	Përbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (TVSH-fondet e bashkisë.	76,184			76,184		
	Shuma 2028	1,860,304	1,165,840	237,360	457,104		
	Shpenzimet për çdo aktivitet 2029	Totali në lekë	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Koordinator lokal të projektit. (50% të orëve) (donatori)	470,070	402,804	67,266			
A.2	Specialist të planifikimit territorial. (30% të orëve) (donatori)	359,450	301,000	58,450			
A.3	Specialist i komunikimit. (20% të orëve) (donatori)	208,950	150,500	58,450			
A.4	Udhëtime (donatori)	81,880			81,880		
A.5	Organizimi i 1 workshope lokale (donatori)	82,500			82,500		
A.6	Youth Soil Innovation Camp – Aktivitete me të rinjtë për promovimin e teknologjive të monitorimit dhe menaxhimit të tokës (donatori)	90,000			90,000		
A.7	Mostra dhe Analiza laboratorike (donatori)	43,420			43,420		
A.8	Ekspertizë për mjedisit/agronom (donatori)	100,000			100,000		
A.9	Ekspertizë juridik për Marrëveshjet Territoriale të Menaxhimit (TMA) (donatori)	50,000			50,000		
A.10	Përbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit (TVSH-fondet e bashkisë	59,560			59,560		
	Shuma 2029	1,545,830	854,304	184,166	507,360		
f) Periudha e zbatimit 2026,2027,2028,2029			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				